

VENDIM
Nr. 267, datë 27.4.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 559, DATË 29.7.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE DHE TARIFAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM/PËRDORIM TË FONDIT PYJOR KOMBËTAR PËR VEPRIMTARI EKONOMIKE DHE PËR PRODHIMET DRUSORE DHE JODRUSORE PYJORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, pika 4, 25, pika 4, dhe 27, pika 5, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 559, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Titulli i vendimit ndryshohet dhe zëvendësohet me “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të Fondit Pyjor Kombëtar, për veprimtari ekonomike dhe prodhimet drusore e jodrusore pyjore, si dhe mënyrën e procedurës së mbledhjes së tyre”.

2. Në bazën ligjore, pas fjalës “... të neneve ...” shtohet togfjalëshi “... 13, pika 4, ...”.

3. Në pikën 1, pas fjalëve “... në Fondin Pyjor Kombëtar ...” shtohen “... dhe mënyrën e procedurës së mbledhjes së tyre ...”.

4. Pas pikës 5 shtohen pikat 5.1, 5.2, 5.3, 5.4, 5.5, 5.6 dhe 5.7, me këtë përmbajtje:

“5.1 Tarifat për dhënie në përdorim të fondit pyjor, sipas shtojcës 1, të këtij vendimi, paguhen çdo vit, nga subjektet që marrin në përdorim fondin pyjor, pavarësisht kohëzgjatjes së kontratës së qirasë për dhënie në përdorim të këtij fondi, të lidhur midis bashkisë, në territorin e së cilës kryhet aktiviteti, dhe subjektit fizik apo juridik që kryen aktivitetin.

5.2 Tarifa vjetore e përcaktuar në pikën 5.1, të këtij vendimi, paguhet në llogarinë bankare të bashkisë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e lidhjes së kontratës dhe në të njëjtën muaj për vitet në vijim.

5.3 Tarifat për sipërfaqen e shfrytëzuar për heqjen nga Fondi Pyjor Kombëtar përcaktohen në raportin tekniko-ekonomik për sipërfaqen pyjore që hiqet, të hartuar nga strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki. Struktura përgjegjëse për pyjet në ministri, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga miratimi i aktit të heqjes nga fondi pyjor, njofton subjektin për kryerjen e pagesës së tarifës. Tarifa paguhet në llogarinë bankare të bashkisë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e njoftimit. Moskryerja e pagesës brenda afatit të përcaktuar përbën kusht për anulimin e aktit të miratimit të heqjes nga fondi pyjor.

5.4 Tarifat për shfrytëzimin e Fondit Pyjor Kombëtar, sipas shtojcës 2, të këtij vendimi, për vendosjen e kampingjeve, qendrave dhe objekteve të lëvizshme janë ditore, bazuar në kontratat sezonale të shfrytëzimit dhe paguhen në momentin e lidhjes së kontratës në llogarinë bankare të bashkisë përkatëse.

5.5 Tarifat, që paguhen për shpërblimin e dëmit të shkaktuar në fondin pyjor, derdhen në llogarinë bankare të bashkisë përkatëse dhe mbledhja e tyre apo ekzekutimi i detyrueshëm bëhet sipas procedurës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

5.6 Tarifat për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore dhe për grumbullimin e nxjerrjen e prodhimeve të dyta pyjore dhe jopyjore, sipas shtojcës 3 të këtij vendimi, paguhen pas shpalljes së fituesit në procedurat e konkurrimit publik dhe lidhjes së kontratës në llogarinë bankare të bashkisë përkatëse.

5.7 Kur veprimtaritë e sipërpërmendura zhvillohen në fondin pyjor privat mënyra dhe procedura e mbledhjes së tarifës përkatëse përcaktohet në marrëveshjen midis pronarit privat dhe subjektit të interesuar.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku